



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote nga shoqëria Skysea B.V.tek shoqëria Tosk Energji.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 556 Prot., protokoll i AK, datë 03.10.2018 “Përqendrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi Tosk Energji SHA nga ana e Skysea B.V” përfaqësuesi ligjor Kalo & Associates ka njoftuar në lidhje me transaksionin e blerjes së shoqërisë Tosk Energji nga shoqëria Skysea B.V, i cili konsiston në blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote në shoqërinë Tosk Energji SHA nga ana e shoqërisë Skysea.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje shit- blerjeje” palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Skysea B.V, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës , me objekt veprimtarie tregti e energjisë elektrike dhe gazit nëpërmjet tubave, etj.

Skysea B.V kontrollohet plotësisht nga Gunvor Group Ltd e cila është nga shoqëritë më të mëdha tregtare të pavarura të lëndëve të para në botë, që operon në mbi 100 vende.

Shoqëria blerëse Skysea BV dhe mëma e saj Gunvor Group LTD nuk janë aktive në tregun shqiptar.

Pala shitëse: CFD Conseils Sàrl, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës, me objekt veprimtarie këshillim, asistencë, ndërmjetësim financiar dhe ofrim shërbimesh në sektorin e lëndëve të para etj.

Target: Tosk Energji SHA, është një shoqëri e themeluar më datë 11.06.2015 sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie nxjerrje, shfrytëzim , përpunim i naftës bruto dhe nën produkteve të saj, import – eksport, etj.

Në datën 05 shtator 2018 është nënshkruar “Marrëveshje shit- blerjeje”, ndërmjet shoqërisë Skysea B.V (blerësi), dhe CFD Conseils Sàrl (shitësi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.